



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.9756/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjykatësin Gëzim Llulluni, në çështjen juridike-përmbare të kreditorit: R.D. nga Ra. , të cilin me autorizim e përfaqëson B.K. avokat në P. , kundër debitorit Komuna e Rahovecit-Drejtoria për Arsim, për përmbaremin e kërkesës në të holla-shujtës, duke vendosur lidhur me ankesën e përfaqësuesit të autorizuar të debitorit, e paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec PPP.nr.38/21 të datës 13 Korrik 2021, me datë 26.07.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar, ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të debitorit Komuna e Rahovecit-Drejtoria për Arsim, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec PPP.nr.38/21 i datës 13 Korrik 2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, në pikën I të dispozitivit refuzohet i pabazuar prapësimi i debitorit Komuna e Rahovecit-Drejtoria për Arsim, i ushtruar kundër Urdhrit për lejimin e përmbaremit, P.nr.34/21 i datës 12.01.2021, i lejuar nga Zyra Përmbaremore e Përmbareuesit Privat Enis Hoxha në Prizren. Me të njëjtin aktvendim në pikën II të dispozitivit është vendosur që secila palë i bartë shpenzimet e përmbaremit në këtë çështje juridike të përmbaremit përveç se deri në përfundimin e procedurës në këtë çështje juridike të përmbaremit , të gjitha shpenzimet e përmbaremit, do t'i bart ajo palë e cila e humb procesin gjyqësor - përmbaremor.

Kundër këtij aktvendimi, brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur përfaqësuesi i debitorit, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës përmbaremore dhe kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, si dhe për shkak të shkeljeve esenciale, me propozim që të aprovohet ankesa e Debitorit, t anulohet Urdhri përmbaremor P.nr.34/21 i dt. 12.01.2021 i Përmbareuesit Privat Enis Hoxha, respektivisht Aktvendimi PPP.nr.38/21 dt.13/.07.2021 I gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec të shfuqizohet , ose të prishet dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe vendosje.

I autorizuari i kreditorit ka paraqitur përgjigje në ankesën e debitorit, me propozim që ankesa e debitorit të refuzohet e pa bazuar dhe të vërtetohet aktvendimi i atakuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 208 dhe 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

Ankesa e përfaqësuesit të debitorit, është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se: kreditori ka paraqitur propozim për përmbartim më datën 12.01.2021 në bazë të titullit përmbartimor me të cilin debitori është detyruar që kreditorit t'ia paguaj në emër të shujtave ditore shumë 624€ dhe atë për 312 ditë pune. Përmbartuesi privat, e ka lejuar përmbartimin e propozuar nga kreditori me Urdhrit P.nr.34/21 dt. 12.01.2021.

Kundër Urdhrit Përmbartues mbi lejimin e përmbartimit brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim përfaqësuesi i debitorit me datën 29.01.2021, me propozim që gjykata të: miratoj prapësimin e debitorit si i bazuar, dhe ta Anulojë Urdhrit Përmbartimor P.nr.34/21, të datës 12.01.2021, të Përmbartuesit Privat Enis Hoxha nga Prizreni, të anulohet urdhri përmbartimor P.nr. 34/21 të dt. 12.01.2021 i Përmbartuesit Privat Enis Hoxha nga Prizreni, të lihen jashtë fuqie të gjitha veprimet e ndërmarra sipas propozimit për përmbartim të kreditorit.

Me përgjigje në prapësim të datës 19.04.2021, i autorizuari i kreditorit ka propozuar që të refuzohet si i pabazuar në ligj prapësimi i debitorit kundër urdhrit për përmbartim dhe urdhri përmbartimor te mbetet ne fuqi.

Gjykata e shkallës së parë, pas vlerësimit të prapësimin, me Aktvendimin e atakuar PPP.nr.38/21, i datës 13 Korrik.2021, ka vendosur që ta refuzoj si të pabazuar prapësimin e debitorit i paraqitur kundër urdhrit mbi lejimin e përmbartimit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se: prapësimi i debitorit është i pa bazuar, sepse debitori në prapësim, nuk është thirrë në asnjë nga shkaqet e përcaktuara në nenin 71 të LPP-së, në bazë të të cilave shkaqe gjykata duhet ta aprovoj prapësimin si të bazuar, kështu që prapësimin e debitorit e ka refuzuar të pa bazuar. Sipas gjykatës Caktimi i përmbartimit është bërë duke u bazuar në vendimin e Inspektoratit të Punës nr. 1740/2020 datë 29.12.2020 me të cilin është detyruar debitori t'ia paguaj kreditorit borxhin në shumë prej 624 € në emër të kompensimit për ushqim për 312 ditë pune. Vendimin e saj gjykata e ka bazuar edhe në atë se vendimi i Inspektoratit në rastin konkret bazohet në nenin 6 par.4 të Ligjit për Inspektoratin e Punës në Kosovë, në bazë të të cilit Përmbartuesi Privat e ka lejuar përmbartimin, sepse ky vendim i plotëson kushte për të qenë dokument përmbartimor sipas dispozitave përkatëse të LPP-së. E drejta për shujtë për ditët e prezencës në punë paditësit i takon mbi bazën e Kontratës Kolektive Sektoriale të Arsimit e dt. 18.04.2017.

Për mënyrën e vendosjes, gjykata e shkallës së parë i është referuar dispozitave ligjore nga neni,71, 22 par.1 pika 1.2, nenit 24, 27, 69 par.4 dhe 73par 3 të LPP-së ka vendosur si në dispozitivin e aktvendimit të atakuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se, gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe gjykata e shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se, aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 lidhur me nenin 208 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të përfaqësuesit të debitorit, as për shkelje tjera të pretenduara, pra as me shkelje nga neni 182 par.2 pika n) të LPK-së pasi që në këtë rast gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes për prapësimin e debitorit, është fakt se nuk ka gjetur se ekziston ndonjëri nga shkaqet ligjore të parapara me nenin 71 të LPP-së, dhe ka marrë aktvendimin e atakuar i cili është në harmoni të plotë dispozitivit me arsyetimin dhe në pjesën arsyetuese janë dhënë arsye konkrete e për faktet me rëndësi vendimtare për një vendosje të tillë.

Me nenin 69 paragrafi 4 të LPP-së, përcaktohet se: *“Baza për prapësim duhet të mbështetet në provat e duhura. Provat për prapësim duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet”*. Në këtë rast i autorizuari i debitorit me anë të prapësimit nuk ka prezantuar asnjë provë me të cilën do të argumentonte ndonjërin nga shkaqet e parapara me nenin 71 të LPP-së, prandaj kjo gjykatë e vlerëson si të drejtë përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë.

Në procedurën përmbartimore, bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor, i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga këto dokumente rrjedhë e drejta e organit përmbartuese, që sipas propozimit të kreditorit, të caktojë dhe zbatoi përmbartimin.

Nga ana e debitorit janë ngritur pretendime ankimore se, ekzistimi i detyrimit për pagesën e shpërblimit jubilar ndaj kreditorit nuk ekziston, për shkaqet e theksuara në prapësim dhe ankesë, të cilat pretendime nuk janë pranuar si të themelta, nga Gjykata e Apelit, sepse në procedurën përmbartimore, gjykata i përmbahet parimit të rigorozitetit formal - juridik, që nënkupton se vlerëson vetëm rrethanat nga të cilat varet lejueshmëria e përmbartimit dhe shkaqet që mund të përbejnë bazë të mjaftueshme për prapësim, ndërsa nuk lëshohet fare në vlerësimin e veprimeve që i referohen procedurës në të cilën është marrë dokumenti përmbartimor.

Me nenin 24 par.2 të LPP-së është përcaktuar se: *“Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbartimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë”*. Ndërsa në paragrafin 5 të po të njëjtit nen është përcaktuar se: *“Përmbartimi caktohet në bazë të vendimi gjyqësor që ende nuk është bërë i formës së prerë ose në bazë të vendimit të dhënë në procedurën administrative që nuk është bërë përfundimtar, vetëm po qe se me ligj është paraparë se ankesa apo mjetet e tjera juridike, nuk e ndalojnë përmbartimin”*.

Gjykata e Apelit vlerëson se, vendimi i Inspektoratit të Punës i nxjerrë në shkallë të parë, lidhur me rastin konkret të kreditorit, është i ekzekutueshëm, pasi që ankesa e ushtruar ndaj të njëjtit nuk e shtyn ekzekutimin, ku kjo klauzolë është e përfshirë edhe në dispozitivin e vendimit të lëshuar nga Inspektorati i Punës me nr.1740/2020 i datës 29.12.2020, ndërsa kjo parashihet edhe me dispozitat e nenit 6.4 të Ligjit Nr. 2002/9 dhe nr. 03/L-017 për Inspektoratin e Punës në Kosovë, ku në mënyrë eksplicite parashihet se *“ankesa e ushtruar në Vendimin e Inspektoratit të Punës, nuk e shtyen ekzekutimin”*.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Nëse pala debitore për çfarë do rrethane apo arsye pretendon se pala kreditore kërkon përmbarimin e detyrimit pa bazë ligjore, si shkak i të cilave palës debitorë eventualisht ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e kryerjes se përmbarimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë, të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt civil pranë gjykatës kompetente, ngase një pretendim i tillë i tij, nuk paraqet bazë ligjore për ndaljen, pezullimin apo përfundimin e përmbarimit në këtë rast.

Nuk qëndron pretendimi ankimor se, në rastin konkret të kreditorit, në cilësi të debitorit është Drejtoria për Arsim, sepse fare qartë që në hyrje të aktvendimit të atakuar, në dispozitiv si dhe në pjesën arsyetuese të tij, në cilësi të debitorit është *Komuna e Rahovecit-Drejtoria për Arsim*, kështu që pretendimi në këtë aspekt edhe për shkelje të nenit 182 par.2 pika k) të LPK-së, u refuzua i pa bazuar.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë, bazohet në dispozitivin e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë, vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 194, 208 dhe 209 paragrafi 1 pika b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.9756/21, me datë 26.07.2022

Gjykatësi
Gëzim Llulluni